

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë // Dpartamenti i Letërsisë Shqipe
Titulli i lëndës:	Letërsi botërore I
Niveli:	Bachelor // Obligative
Viti i studimeve:	III (Semestri V)
Numri i orëve në javë:	3 (tri) // Vlera në kredi – ECTS: 6 (gjashtë)
Koha / lokacioni:	E enjte, 09 – 12, salla 78
Përshkrimi i lëndës	
	<i>Ky kurs përfshinë materien letrare të letërsisë botërore që nga fillimet në Orientin e lashtë (letërsia egiptase, mesopotameze etj...) deri në shekullin XIV, e.r. (fundi i Mesjetës). Trajton vepra letrare, autorë e dukuri sipas rrjedhës historike (sipas epokave, formacioneve stilistike, drejtimeve, rrymave, lëvizjeve...) si dhe sipas zhvillimeve zhanrore (gjinitë, zhanret e llojet letrare), me theks të veçantë në analizën e veprave më përfaqësuese të të gjithë letërsisë. Përqendrimi i veçantë do të jetë tek mitologjia greke, epi grek dhe sidomos drama greke si dhe format letrare të letërsisë romake.</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Gjatë gjithë kohës së zhvillimit të ligjëratave, ushtrimeve e konsultimeve si dhe në përfundim të kursit studentët do të kenë mundësinë:</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të demonstrojnë njohuri për letërsinë e shkruar në vende të ndryshme e në periudha të ndryshme historiko – letrare, për gjuhët, kulturat dhe traditat letrare;</i> • <i>Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike – analitike;</i> • <i>Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare;</i>
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Ligjërata, seminare, diskutime, punë në grupe, shkrime esesh,</i>
Metodat e vlerësimit:	<i>Vlerësimi i parë: 15 %; Vlerësimi i dytë 15 % Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10 % Vijimi i rregullt 10 % Provimi final 50 % Total 100%</i>
Literatura	
Literatura bazë:	<i>Epi i Gilgameshit (veçanërisht Pllakat I, VI, VII, XI, XII); Mësimet e Ptahotepit (Libri më i lashtë i botës), Tiranë, 2006; Dhjata e vjetër (Libri i gjenezës, Libri mbi Jobin, Psalmet, Kënga e këngëve); Saadiu: “Gjylistani dhe Bostani”, Omar Khajami: Rubairat; Përrallat arabe “1001 net”(zgjedhje ose “Në hijen e hurmave” (përkthyes Faik Konica)), Homeri: Iliada (sidomos këngët: I, VI, XXII, XXIV), Odiseja (këngët: I, XI, XXIII, XXIV), Safo: Poezi të zgjedhura, Anakreonti: Poezi të zgjedhura; Eskili: Prometheu i ngujuar, Orestia; Sofokliu: Antigona,</i>

	Mbreti Edip , Euripidi: Medeja , Andromaka , Aristofani: Bretkosat , Lisistrata , Aristoteli: Poetika ; Plauti: Menehmët ; Virgjili: Eneida (Këngët: I, IV, VI, XII),
Literatura shtesë:	Grup autorësh: Historia e letërsisë botërore 1, 2, Prishtinë 1984 etj. P. S. Kohan: Historia e letërsisë së vjetër greke, Shkup 1990 N. A. Kun: Poezia epike greke, Tiranë, 2003 Jean – Pierre Vernant: Gjithësia, Perënditë, Njerët, Tiranë, 2012 Osman Gashi: Kufijtë e letërsisë, Prishtinë 2008 Osman Gashi: Letërsia dhe miti, Prishtinë, 2014 Todi Dhama: Fjalori i mitologjisë, Prishtinë, 1988 Muzafer Xhaxhiu: Letërsia antike greke... V. Zamarovski: Heronjtë e miteve antike, Prishtinë, 1988 Timo Shkurti: Mitologjia, Tiranë, 2003 Ismail Kadare: Eskili, ky humbës i madh, Prishtinë, 1990
Plani i disenjuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Letërsia e lashtë e egjiptase; miti, poezia, tekstet e piramidave; “Libri i të vdekurve”
<i>Java e dytë:</i>	Letërsia sumere dhe babilono-asiriane; dokumentet e kulturës sumere, babilonase, asirase; epi “Gilgameshi”
<i>Java e tretë:</i>	Letërsia e lashtë hindase: lirika (Brahmanet, Vedat, Upanishadat); epika: “Mahabharata”; epiko-lirika: “Ramajana”; proza (“Pançatantra”, ”Xhataki”); drama e hershme: Kalidasa: “Sakuntala”
<i>Java e katërt:</i>	“Letërsia e lashtë ebreje; Bibla dhe veçoritë e saj; “Dhjata e vjetër” (përbërja dhe krijimi, baza historike, vlerat letrare)
<i>Java e pestë:</i>	Letërsia persiane: Firdusi (pjesë nga lirika dhe “Shahnameja”); lirika: Khajami, “Rubairat”; Saadiu - “Gjylistani dhe Bostani”; shembuj nga poezia e Nizamit, Rudakit, Enverit, Hafizit, Xhamiut, Rumiut etj
<i>Java e gjashtë:</i>	Letërsia arabe: veçoritë e përgjithshme; veçoritë letrare të Kur’anit; cikli i përrallave “1001 net”
<i>Java e shtatë:</i>	Letërsia antike greke; periodizimi, burimet kryesore dhe miti grek
<i>Java e tetë:</i>	Epi, prejardhja dhe llojet; Homeri dhe çështja homerike; “Iliada” dhe “Odiseja”
<i>Java e nëntë:</i>	Epi didaktik: Hesiodi, “Punët dhe ditët”, ”Teogonia”; Lirika antike greke
<i>Java e dhjetë:</i>	Zhvillimi i dramaturgjisë dhe i teatrit grek; Vepra e Eskilit
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Sofokliu dhe Euripidi
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Krijimi dhe zhvillimi i komedisë; Aristofani; proza dhe llojet tjera letrare
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Letërsia romake (historia, zhvillimet, gjinitë letrare)
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Poezia epike: Virgjili, “Eneida”
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Letërsia e Mesjetës (veçoritë themelore)